

31071

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS PARË TIRANE.
NR. AKTIT. 31071

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK.

Në Tiranë, sot më datë 23/2 2004, Unë Gjyqtari/a kësaj Gjykate,
[3q], mbasi u njoha dhe studiova kërkesën dhe materialet e paraqitura prej Ortakut të vetëm dhe Administrator, Hysen MALKJA, për regjistrim si person juridik të shoqërisë "Rc & Al" Shpk Peqin në regjistrin tregëtar,

K O N S T A T O V A :

Se Zoti Hysen MALKJA, ka paraqitur kërkesë me të cilën kërkon regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Rc & Al" Shpk Peqin, me Seli në adresën Lagja "Xhami" Peqin, me Administrator të shoqërisë Ortaku i vetëm, Zoti Hysen MALKJA, kohë zgjatja e shoqërisë është pa afat, Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 lekë, me Objekt të veprimtarisë :

- = Kryerja e Studimeve dhe Projektimeve urbanistike ;
- = Studimi dhe hartimi i Projekteve dhe i Preventivave për punim-montime në ndërtimin e veprave të ndryshme.
- = Kryerja e Punimeve :
- jashtë sheshit të ndërtimit të ndërtesave të ndryshme, si Ujësjiellësit, kanalizimet, rrugët, linjat ajrore e nëntoksore si dhe veprat e artit në rrugët, hekurudhat e tjera.
- në ndërtesa banimi, social-kulturore, ekonomike, të shërbimit dhe industriale.
- për rikonstruksionin dhe zgjerimin e veprave ekzistuese
- për Kullim-ujitje e mbrotje nga lumenjtë
- = Kryerja e kolaudimit përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimeve.
- = Transport i materialeve të ndërtimit.
- = Lidhja e marrëveshje e nënshkrimi kontratave sipërmarrje, me persona fizik e juridik, vëndas e të huaj, si brënda dhe jashtë Shqipërisë.
- = Kryerje e Veprimtarisë për shfrytëzimin e materialeve inerte, zhavoreve dhe rërërave, që nxiren nga shtretërit e brigjet e lumenjve, përenjve, liqeneve e tj. qofshin me ose pa ujë.
- = Shoqëria gëzon të drejtën të importojë e eksportojë dërgesa me material ndërtimi, bazuar dhe sipas nevojave që i paraqiten për realizimin e aktivitetit e të qëllimeve të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Nga materialet që janë paraqitur, rezulton se veprimtaria e shoqërisë përputhet me kriteret e përcaktuara në ligjin Nr. 7638 Datë 11.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare", të Ligjit Nr. 7667 Datë 28.01.1993 "Për Regjistrin

tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare" dhe të akteve të tjera nënligjore që kanë dalë në zbatim të tyre.

Për këtë arsye, kërkesa e bërë për regjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "RE & AL" SHPK PEQIN si person juridik duhet pranuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në nenet 13,17,e 19 të ligjit 7632 Datë 04.11.1992, neneve 12,37e vijues të Ligjit Nr. 7638 datë 11.11.1992 dhe neneve 2 e 24 të ligjit 7667, datë 28.01.1993

V E N D O S A :

Pranimin e kërkesës.

Të regjistroj shoqërinë "Re & Al" Shpk Peqin si person juridik, me Administrator të shoqërisë Ortaku i vetëm, Zoti Hysen MALKJA, me Seli në adresën Lagja "Xhami" Peqin, me objekt veprimtarie :

- = Kryerja e Studimeve dhe Projektiveve urbanistike ;
- = Studimi dhe hartimi i Projekteve dhe i Preventivave për punim-montime në ndërtimin e veprave të ndryshme.
- = Kryerja e Punimeve :
 - jashtë sheshit të ndërtimit të ndërtesave të ndryshme, si Ujësjiellësit, kanalizimet, rrugët, linjat ajrore e nëntoksore si dhe veprat e artit në rrugët, hekurudhat e tjera.
 - në ndërtesa banimi, social-kulturore, ekonomike, të shërbimit dhe industriale.
 - për rikonstruksionin dhe zgjerimin e veprave ekzistuese
 - për Kullim-ujitje e mbrotje nga lumenjtë
- = Kryerja e kolaudimit përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimeve.
- = Transport i materialeve të ndërtimit.
- = Lidhja e marrëveshje e nënshkrimi kontratave sipërmarrje, me persona fizik e juridik, vendas e të huaj, si brenda dhe jashtë Shqipërisë.
- = Kryerje e Veprimtarisë për shfrytëzimin e materialeve inerte, zhavoreve dhe rërërave, që nxiren nga shtretërit e brigjet e lumenjve, përenjve, liqeneve e tj. qofshin me ose pa ujë.
- = Shoqëria gëzon të drejtën të importojë e eksportojë dërgesa me material ndërtimi, bazuar dhe sipas nevojave që i paraqiten për realizimin e aktivitetit e të qëllimeve të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 lekë,
Kohë zgjatja e shoqërisë është pa afat.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E.

Be Kule (Bj)
01/30/92

V E N D I M

I GJYQTARES TË VETME

Sot më datë 01. Prill 2005, Unë Gjyqtaria e Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, **A. Cecco**, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur prej Administratorit të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, Zotit Hysen Malkja, për depozitimin në regjistrin tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, të dokumentave të paraqitura, Vendimi nr. 1 datë 15 Mars 2005, të ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN.

K O N S T A T O V A

Se me Vendimin Nr. 31071 datë 23.02.2004 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është regjistruar si person juridik shoqëria "RE & AL" SHPK PEQIN, me ortak të vetëm dhe administrator i shoqërisë, Zotin Hysen MALKJA.

Me vendimin Nr.1 datë 15 Mars 2005, të ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, është vendosur :

= Të hartohet Raporti i Ekspertit Kontabël të Autorizuar, për vlerësimin e kontributeve në natyrë (të pasurisë të paluajtëshme dhe të luajtëshme, makineri), në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, si dhe,

Për të realizuar Raportin për vlerësimin e kontributeve në natyrë në Kapitalin Themeltar të shoqërisë, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, është caktuar Eksperti Kontabël i Autorizuar për vlerësimin e kontributeve, Zoti Andon Kristo, me Nr. liçense "05", dt. 10.02.2000.

Kërkuesi kërkon depozitimin e këtij akti të shoqërisë në Regjistrin Tregëtar, pranë Gjykatës të Shkallës Parë Tiranë.

Kërkesa dhe aktet janë në përputhje me ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGËTARE", ndaj çmohet se duhet pranuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr 7638 Datë 19.11.1992, "PËR SHOQËRITË TREGËTARE" dhe Ligji Nr.7667 datë 28.01.1993

"PËR REGJISTRIN TREGËTAR DHE FORMALITETET QË DUHEN RESPEKTUAR NGA SHOQËRITË TREGËTARE", neni 2

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës

Depozitimn në Regjistrin Tregëtar të akteve të paraqitura :

VENDIMI NR. 1 DATE 15 Mars 2005

Urdhërimin e zyrës së regjistrit tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë,
të bëjë shënimet përkatëse në kolonën 4 dhe 5
Të ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vijë të kuqe.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E

Arta me Coco

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Arta me Coco' written in a stylized, cursive script.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA SHKALLËS PARË TIRANË

NR. 31071/2 AKTIT.

V E N D I M

I GJYQTARES TË VETME

Sot më datë, 12. Prill 2005, Unë Gjyqtaria e Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, *M. Dega*, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur prej Administratës së shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, Zotit Hysen Malkja, për depozitim në regjistrin tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, të dokumentave të paraqitura, Vendimi nr. 2 datë 18 Mars 2005, të ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN.

K O N S T A T O V A

Se me Vendimin Nr. 31071 datë 23.02.2004 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është regjistruar si person juridik shoqëria "RE & AL" SHPK PEQIN, me ortak të vetëm dhe administrator i shoqërisë, Zotin Hysen MALKJA.

Me Vendimin Nr. 31071/1 datë 01.Prill.2005 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është depozituar pranë Regjistrin tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, vendimi Nr.1 datë 15 Mars 2005 i ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, me të cilin është vendosur Hartimi i Raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe është caktuar ekspert kontabël, Zoti Andon Kristo, me Nr. liçense "05", dt. 10.02.2000.

Me vendimin Nr.2 datë 18 Mars 2005, të ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, është vendosur Miratimi i Raportit të përgatitur prej ekspertit Kontabël të Autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, dhe bazuar në vlerësimet e raportit, është Miratuar ritja e Kapitalit Themeltar Shoqërisë edhe me shumën 35.900.000 lekë, duke mbritur në total Kapitali themeltar i shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, në shumën 36.000.000 (Tridhjetë-e-gjashtë-milionë) Lekë.

Shuma e Kapitalit Themeltar është kontribut i ortakut të vetëm të shoqërisë

Kërkuesi kërkon depozitim të këtij akti të shoqërisë në Regjistrin Tregëtar, pranë Gjykatës të Shkallës Parë Tiranë.

Kërkesa dhe aktet janë në përputhje me ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGËTARE", ndaj çmohet se duhet pranuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr 7638 Datë 19.11.1992, "PËR SHOQËRITË TREGËTARE" dhe
Ligji Nr.7667 datë 28.01.1993

"PËR REGJISTRIN TREGËTAR DHE FORMALITETET QË DUHEN RESPEKTUAR NGA SHOQËRITË TREGËTARE", neni 2

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës

Depozitimn në Regjistrin Tregëtar të akteve të paraqitura :

= VENDIMI NR. 2 DATË 18 Mars 2005


= Raporti ekspertit kontabël të autorizuar për vlerësimin e kontributeve në
natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN.

= Çertifikatë për vërtetim pronësie, copë 4 (katër) me nr. i pasurisë :
Nr.111, Nr. 112, Nr. 113/1, Nr.114/1

Urdhërimin e zyrës së regjistrit tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë,
të bëjë shënimet përkatëse në kolonën 4 dhe 5

Të ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vijë të kuqe.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E


31071 / 3

V E N D I M

I GJYQTARES TË VETME

Sot më datë, 31 / Maj, 2005, Unë Gjyqtaria e Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, E. Bija, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur prej Administratorit të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, Zotit Hysen Malkja, për depozitim në regjistrin tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, të dokumentave të paraqitura prej ortakut të vetëm dhe administrator i shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, Vendimi nr. 3 datë 19 Mars 2005, dhe Kontratat e shitjes të pjesëve të Kapitalit themeltar të shoqërisë,

K O N S T A T O V A

Se me Vendimin Nr. 31071 datë 23.02.2004 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është regjistruar si person juridik shoqëria "RE & AL" SHPK PEQIN, me ortak të vetëm dhe administrator i shoqërisë, Zotin Hysen MALKJA.

Me Vendimin Nr. 31071/1 datë 01.Prill.2004 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është depozituar pranë Regjistrimit tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, vendimi Nr.1 datë 15 Mars 2005 i ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, me të cilin është vendosur Hartimi i Raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe është caktuar eksperti kontabël.

Me Vendimin Nr. 31071/2 datë 12 Prill 2005 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është depozituar pranë Regjistrimit tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, vendimi Nr.2 datë 18 Mars 2005, me të cilin :
= është miratuar Raporti i ekspertit Kontabël të Autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, dhe bazuar në këtë raport,
= është miratuar ritja e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë edhe me shumën 35.900.000 lekë, duke mbritur në total Kapitali themeltar i shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, në shumën 36.000.000 (Tridhjetë-e-gjashtë-milionë) Lekë.

Me vendimin nr. 3 datë 19.03.2005, Ortaku i vetëm i shoqërisë, VENDOSI : Të transferojë në persona të tretë me akt shitje pjesë të kapitalit themeltar, në masën 90 % të kapitalit të shoqërisë.

Ky transferim është realizuar me kontrata e shitblerjes, respektivisht :
Rexhep Biça, ka blerë 57 % të pjesëve kapitalit themeltar të shoqërisë, me kontratën nr. Rep. 601 Kol. 40 datë 22.03.2005
Dashmir Malkja ka blerë 16 % të pjesëve kapitalit themeltar të shoqërisë, me kontratën nr. Rep. 602 Kol. 41, datë 22.03.2005

Dulejman Zeka, blerë 17 % të pjesëve kapitalit themeltar të shoqërisë, me kontratën nr. Rep. 603 Kol. 42 datë 22.03.2005

Kërkuesi kërkon depozitim të këtij akti të shoqërisë në Regjistrin Tregëtar, pranë Gjykatës të Shkallës Parë Tiranë.

Kërkesa dhe aktet janë në përputhje me ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGËTARE", ndaj çmohet se duhet pranuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr 7638 Datë 19.11.1992, "PËR SHOQËRITË TREGËTARE" dhe Ligji Nr.7667 datë 28.01.1993

"PËR REGJISTRIN TREGËTAR DHE FORMALITETET QË DUHEN RESPEKTUAR NGA SHOQËRITË TREGËTARE", neni 2

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës

Depozitim në Regjistrin Tregëtar të akteve të paraqitura :

= VENDIMI NR. 3 DATË 19 Mars 2005

Kontratën nr. Rep. 601 Kol. 40 datë 22.03.2005

Kontratën nr. Rep. 602 Kol. 41, datë 22.03.2005

Kontratën nr. Rep. 603 Kol. 42 datë 22.03.2005

Urdhërimin e zyrës së regjistrit tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, të bëjë shënimet përkatëse në kolonën 4 dhe 5

Të ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vijë të kuqe.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E

Burimë Buj
ajg

V E N D I M

I GJYQTARES TË VETME

Sot më datë, .Qershor 2005, Unë Gjyqtaria e Gjykatës Shkallës Parë Tiranë *Albano*
Leeskaj, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur prej Administratorit të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, Zotit Rexhep Biça, për depozitim në regjistrin tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, të akteve të paraqitura prej tij, në cilësinë e administratorit të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, Vendimi nr. 4 datë 23 Mars 2005 si dhe Statutin e ndryshuar të Shoqërisë,

K O N S T A T O V A

Se me Vendimin Nr. 31071 datë 23.02.2004 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është regjistruar si person juridik shoqëria "RE & AL" SHPK PEQIN, me ortak të vetëm dhe administrator i shoqërisë, Zotin Hysen MALKJA.

Me Vendimin Nr. 31071/1 datë 01.Prill.2005 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është depozituar pranë Regjistrin tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, vendimi Nr.1 datë 15 Mars 2005 i ortakut të vetëm të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, me të cilin është vendosur Hartimi i Raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe është caktuar eksperti kontabël.

Me Vendimin Nr. 31071/2 datë 12.04.2005 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është depozituar në regjistrin tregëtar pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, Vendimi Nr. 2 datë 18 Mars 2005, me të cilin :
= është miratuar Raporti i ekspertit Kontabël të Autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, dhe bazuar në këtë raport,
= është miratuar ritja e kapitalit themeltar të shoqërisë edhe me shumën 35.900.000 lekë, duke mbritur në total Kapitali themeltar shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN, në shumën 36.000.000 (Tridhjetë-e-gjashtë-milionë) Lekë.

Me Vendimin Nr. 31071/3 datë 31.Maj.2005 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, është depozituar në regjistrin tregëtar pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, Vendimi Nr. 3 datë 19 Mars 2005, i ortakut të vetëm të shoqërisë, për realizimin e shitjes të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë "RE & AL" SHPK PEQIN., si dhe kontaktat përkatëse të realizimit të shitjes së pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me vendimin nr. 4 datë 23.03.2005, Asambleja e ortakëve të shoqërisë,

VENDOSI :

- 1 TË MIRATOJË NDRYSHIMET E BËRA NË STATUTIN E SHOQËRISË.
- 2 TË SHKARKOJË NGA FUNKSIONI I ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË, ZOTIN HYSEN MALKJA
- 3 TË EMËROJË ADMINISTRATOR TË SHOQËRISË, ZOTIN REXHEP BIÇA
- 4 TË DEPOZITOHEN NË REGJISTRIN TREGËTAR PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS PARË TIRANË, AKTET :
= VENDIMI NR. 4 DATË 23.03.2005
= STATUTI I NDRYSHUAR I SHOQËRISË

Kërkuesi kërkon depozitimimin e këtyre akteve të shoqërisë në Regjistrin Tregëtar, pranë Gjykatës të Shkallës Parë Tiranë.

Kërkesa dhe aktet janë në përputhje me ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGËTARE", ndaj çmohet se duhet pranuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr 7638 Datë 19.11.1992, "PËR SHOQËRITË TREGËTARE" dhe Ligji Nr.7667 datë 28.01.1993 "PËR REGJISTRIN TREGËTAR DHE FORMALITETET QË DUHEN RESPEKTUAR NGA SHOQËRITË TREGËTARE", neni 2

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës


Depozitimimin në Regjistrin Tregëtar të akteve të paraqitura :

= VENDIMI NR. 4 DATË 23.03.2005
= STATUTI I NDRYSHUAR I SHOQËRISË

Urdhërimin e zyrës së regjistrit tregëtar të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, të bëjë shënimet përkatëse në kolonën 4 dhe 5
Të ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vijë të kuqe.


Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E



A K T T H E M E L I M I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Re & Al" Shpk. Peqin



NENI 1 *Formimi*

Në Peqin, sot, më datë 25 Janar të vitit 2004 (dymijëekatër), Unë,
Hysen MALKJA, i biri i Ismail-it dhe i Shpresa-s, lindur më 16 Gusht të vitit 1963 në Peqin, me Kombësi e Shtetësi Shqiptare, banues në adresën Lagja "XHAMI" Peqin, me dokument identifikimi, Pasaporta Nr. Z 0122106, me vullnet të lirë vendosa krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm "Re & Al" Shpk Peqin

NENI 2 *Regjimi Juridik*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, "Re & Al" Shpk. Peqin, do të realizoj aktivitetin e saj, bazuar e në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë *

NENI 3 *Emërtimi*

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është:
"Re & Al "Shpk,Peqin

NENI 4 *Selia*


Selia e shoqërisë do të jetë në adresën Lagja "XHAMI" Peqin.
Shoqëria do të ketë stemën e saj, në bazë të përmbajtjes të veprimtarisë së shoqërisë, e cila duhet të figurojë në të gjitha materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të saj.
Përmbajtja e vulës së shoqërisë është :
"Republika e Shqipërisë Re & Al Shpk.Peqin"

NENI 5 *Kohëzgjatja*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, "Re & Al" Shpk Peqin, caktohet të funksionoj për periudhë kohe pa afat.
Ortakut të vetëm i njihet e drejta që mund të ndryshojnë afatin e zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë.

NENI 6 *Objekti i veprimtarisë.*

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj si "Re & Al" SHPK PEQIN



aktiviteti shoqërisë do të jetë

= Kryerja e Studimeve dhe Projektmeve urbanistike ;
= Studimi dhe hartimi i Projekteve dhe i Preventivave për punim-montime në ndërtimin e veprave të ndryshme.

= Kryerja e Punimeve :

- jashtë sheshit të ndërtimit të ndërtesave të ndryshme, si Ujësjiellësit, kanalizimet, rrugët, linjat ajrore e nëntoksore si dhe veprat e artit në rrugët, hekurudhat e tjera.
- në ndërtesa banimi, social-kulturore, ekonomike, të shërbimit dhe industriale.

- për rikonstrukcionin dhe zgjerimin e veprave ekzistuese
 - për Kullim-ujitje e mbrotje nga lumenjtë
- = Kryerja e kolaudimit përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimeve.
= Transport i materialeve të ndërtimit.

= Lidhja e marrëveshje e nënshkrimi kontratave sipërmarrje, me persona fizik e juridik, vëndas e të huaj, si brënda dhe jashtë Shqipërisë.
= Kryerje e Veprimtarisë për shfrytëzimin e materialeve inerte, zhavoreve dhe rërërave, që nxiren nga shtretërit e brigjet e lumenjve, përenjve, liqeneve e tj. qofshin me ose pa ujë.

= Shoqëria gëzon të drejtën të importojë e eksportojë dërgesa me material ndërtimi, bazuar dhe sipas nevojave që i paraqiten për realizimin e aktivitetit e të qëllimeve të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 7 *Kapitali Themeltar i shoqërisë*

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqindmijë) lekë.
Shuma e Kapitalit Themeltar të depozituar është kontribut i ortakut të vetëm të shoqërisë
Kapitali themeltar është i ndarë në pjesë me vlerë nominale të barabarta me 1000 (njimijë) lekë.

NENI 8 *Organet Drejtuese të Shpk*

Shoqëria "Rc & Al" Shpk Peqiu, fiton statusin e personit juridik nga momenti i regjistrimit në regjistrin tregëtar pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë. Shoqëria do të administrohet nga person fizik.
Drejtimi i shoqërisë i caktohet Ortakut të vetëm, Zotit Hysen MALKJA, i cili caktohet Administrator i shoqërisë.

Çdo përcaktim për kushte e kritere për të qënë administrator i bërë nga ortakut i vetëm dhe i shënuar në statut, mer fuqi detyruese.
Ortakut i vetëm, si Përfaqësues ligjor i shoqërisë, ka kompetencë të kryej të gjitha aktet që lidhen me objektin e shoqërisë, Ai ka kompetencë për t'a angazhuar shoqërinë në kufijt e objektit të saj.

Mardhëniet e punës në shoqëri, me të punësuarit në administratën e shoqërisë, regullohen bazuar në kontratën personale të punës, e cila redaktohet nga palët bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.



Mardhëniet me tretët.

Nuk mund të pranohet në shoqëri një person i tretë pa miratimin e ortakut të vetëm.

NENI 10 *Administrimi i Shoqërisë :*

Ortaku i vetëm administrator, në mbyllje të çdo ushtrimi financiar, është i detyruar të përgatisi llogaritë vjetore mbështetur në të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarit, si dhe në raportin e administrimit. Rezultatet e ushtrimit financiar, mbas ndarjes së rezervës së domosdoshme (bazuar dhe sipas përcaktimeve ligjore) dhe, (sipas rastit në rast se ka vënd) mbas mbulimit të humbjeve, vendoset nga ortaku i vetëm përdorimi i tyre (për ushqyerje të rezervës ose shpërndarje ortakut.)

NENI 11 *Shpërndarja e shoqërisë:*

Shpërndarja e shoqërisë bëhet :

Me realizimin e objektit të përcaktuar,

Në rastet e pamundësisë të realizimit të objektit,

Pushimi veprimtarisë për arsye objektive,

Me vendim të ortakut të vetëm, mënyrë të përshpejtuar me deklaram të aktit në gjykatë,

Me vendim gjyqësor,

Si dhe në raste të tjera të parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi në R.Sh.

NENI 12 *Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*

Në rast të lindjes së konflikteve ndërmjet ortakut të vetëm dhe cilitdo prej të punësuarve në shoqëri, nga ana e dy palëve duhet të bëhet kujdes dhe angazhim për zgjidhje të konfliktit me mirkuptim, në rast të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjeve të lindura kërkohet në rrugë gjyqësore

T H E M E L U E S I I S H O Q Ë R I S Ë

Hysen MALKJA

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Re & Al" Shpk. Peqin



KREU I I

FORMA, EMËRTIMI, SELIA, AFATI.

NENI 1 *Forma*

Në Peqin, sot më datë 25 Janar të vitit 2004 (dymijëekatër), Unë Themeluesi i shoqërisë, Hysen MALKJA, i biri i Ismail-it dhe i Shpresa-s, lindur më 16 Gusht të vitit 1963 në Peqin, me Kombësi e Shtetësi Shqiptare, banues në adresën Lagja "XHAMI" Peqin, i martuar, me dokument identifikimi, Pasaporta Nr. Z 0122106, Vendosa :

Të formoj shoqërinë, që më poshtë për lehtësi do të quhet thjesht "Shoqëria", duke zgjedhur formën e "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" me Ortak të vetëm. Për këtë qëllim, (Përveç Aktit të themelimit të shoqërisë), hartova, miratova dhe nënshkrova këtë Statut, i cili do të jetë dokumenti bazë që do të rregullojë veprimtariën e shoqërisë.

NENI 2 *Emërtimi*

Emërtimi i shkurtuar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është
"Re & Al" Shpk Peqin

NENI 3 *Selia*

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën Lagja "XHAMI" Peqin. Shoqëria do të ketë stemën e saj, në bazë të përmbajtjes të veprimtarisë së shoqërisë, e cila duhet të figurojë në të gjitha materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të saj.

Përmbajtja e vulës së shoqërisë është :
"Republika e Shqipërisë Re & Al Shpk,Peqin"

NENI 4 *Kohë Zgjatja e Shoqërisë*

Afati i veprimtarisë të shoqërisë është pa afat. Veprimtaria e shoqërisë fillon ditën e që Ajo fiton Statusin Juridik, Ortakut të vetëm njihet e drejta të ndryshojë afatin e veprimtarisë të shoqërisë.

KREU I II

OBJEKTI, KAPITALI THEMELTAR, REGJIMI JURIDIK.



Objekti i Veprimtarisë Shoqërisë :

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj si "Rc & AI" Shpk Peqin

Aktiviteti shoqërisë do të jetë

- = Kryerja e Studimeve dhe Projektimeve urbanistike ;
- = Studimi dhe hartimi i Projekteve dhe i Preventivave për punim-montime në ndërtimin e veprave të ndryshme.
- = Kryerja e Punimeve :
 - jashtë sheshit të ndërtimit të ndërtesave të ndryshme, si Ujësjiellësit, kanalizimet, rrugët, linjat ajrore e nëntoksore si dhe veprat e artit në rrugët, hekurudhat e tjera.
 - në ndërtesa banimi, social-kulturore, ekonomike, të shërbimit dhe industriale.
 - për rikonstrukcionin dhe zgjerimin e veprave ekzistuese
 - për Kullim-ujitje e mbrotje nga lumenjtë
- = Kryerja e kolaudimit përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimeve.
- = Transport i materialeve të ndërtimit.
- = Lidhja e marrëveshje e nënshkrimi kontratave sipërmarrje, me persona fizik e juridik, vëndas e të huaj, si brënda dhe jashtë Shqipërisë.
- = Kryerje e Veprimtarisë për shfrytëzimin e materialeve inerte, zhavoreve dhe rërërave, që nxiren nga shtretërit e brigjet e lumenjve, përenjve, liqeneve e tj. qofshin me ose pa ujë.
- = Shoqëria gëzon të drejtën të importojë e eksportojë dërgesa me material ndërtimi, bazuar dhe sipas nevojave që i paraqiten për realizimin e aktivitetit e të qëllimeve të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 6 Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria fiton statusin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Gjykatës të Shkallës Parë Tiranë.

Shoqëria veprimtarinë e saj e ushtron bazuar në Aktin e Themelimit të Shoqërisë, në këtë Statut, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë *

Në marrëdhëniet juridike me të tretët, shoqëria vepron në emër e për llogari të vet. Nuk mund të pranohet në shoqëri një person i tretë pa miratimin e ortakut të vetëm.

Shoqëria në cilësinë e personit juridik, ka të drejtë dhe mund të marrë përsipër detyrime civile, si dhe të paditë e të paditet përpara organeve kompetente gjyqësore.

Shoqëria ka të drejtë të mari pjesë si ortakë në shoqëri të tjera, në teritorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 7 Kapitali Themeltar i Shoqërisë

Vlera Minimale e Kapitalit Themeltar të shoqërisë është përcaktuar në vlerën 100.000 (njiqindmijë) lekë dhe, përbëhet nga kontribut i derdhur në lekë nga ortaku i vetëm.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është i ndarë në kuota të nënshkruara nga ortaku i vetëm, vlera nominale e të cilave është caktuar 1000 (njimijë) lekë secila.

Fondet që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë janë të depozituara në llogarin rjedhese në:

Banka e Kursimeve Dega Peqin, librezë nr. 9531 datë 16 dhjetor 2003.

Ortaku i vetëm me vendim unilateral të veçantë, mund të shtojë Kapitalin Themeltar të shoqërisë në përputhje me kërkesat e ligjit.

Po ashtu, Ai mund të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë, por në asnjë rast nën vlerën e minimumit të përcaktuar në këtë statut.

Ortakut të vetëm i njihet e drejta të Transferojë kuota, pjesë të Kapitalit Themeltar, si me trashëgimi ose brënda familjes, ashtu si dhe mund t'i transferojë lirisht në persona të tretë.

K R E U III

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 8 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË :

- = Organi vendimmarës është Ortaku i vetëm ;
- = Organi ekzekutiv i shoqërisë është Administratori.

NENI 9 ORGANI VENDIMMARËS


Të drejtat e Përfaqësuesit të shoqërisë.

Ortaku i vetëm.

Shoqëria, në veprimtarinë e saj, për realizimin e objektit përfaqësohet prej Ortakut të vetëm, i cili është organi më i lartë vendim-marrës i shoqërisë.

Ortaku i vetëm shprehhet me vendime personale në lidhje me :

- = Ndryshimin e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të Shoqërisë ;
- = Ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë ;
- = Ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë ;
- = Riorganizimin ose prishjen e shoqërisë ;
- = Përcakton rastet e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratave për kryerjen e investimeve në funksion të plotësimit të nevojave të shoqërisë si dhe në rastet për marje hua, lënie peng apo hypotekim të pasurisë së shoqërisë ;
- = Miraton raportin vjetor të veprimtarisë dhe rezultatet ekonomike-financiare të shoqërisë, të realizuara nga administratori i shoqërisë ;
- = Vendos për mbulimin e humbjeve dhe sigurimin e rezervës ;
- = Vendos për hapjen apo mbylljen e filialeve apo të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.
- = Emëron administratorin si dhe mund të delegoj kompetencat e veta ;
- = Përcakton kompetencat e administratorit dhe detyrat që ai duhet të



- = Realizoj bazuar dhe në përputhje me objektin dhe veprimtarinë e shoqërisë.
- = Miraton projektet për zgjerimin e veprimtarisë së shoqërisë ;
- = Ortaku i vetëm përcakton llojin e të dhënave e të informatave që janë e përbëjnë sekretin e shoqërisë, të cilat nuk lejohen të përhapen në të tretë.
- = Vendos me të drejtën e disponimit ekskluziv të pasurisë të shoqërisë ;
- = Ortaku i vetëm përgjigjet materialisht ndaj të tretëve për detyrimet e shoqërisë, deri në masën e kontributit të tij në Kapitalin Themeltar të shoqërisë.
- = Të gjitha vendimet e mara nga ortaku i vetëm firmosen dhe regjistrohen në regjistër të posaçëm që mbahet pranë shoqërisë.

NENI 10

ORGANI EKZEKUTIV

Administratori

Çdo përcaktim për kushte e kritere për të qënë administrator i bërë nga ortaku i vetëm dhe i shënuar në këtë statut, mer fuqi detyruese. Kompetencat e administratorit përcaktohen nga ortaku i vetëm në përputhje me detyrat që ai duhet të realizoj bazuar dhe, në përputhje me objektin dhe veprimtarinë e shoqërisë.

Administratori, në cilësinë e Përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ka kompetencë të kryej të gjitha aktet që lidhen me objektin e shoqërisë, Ai ka kompetencë për t'a angazhuar shoqërinë në kufijt e objektit të saj. Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

Ai kryen dhe realizon drejtimin administrativ të shoqërisë :

- = Në funksion të realizimit të objektit të shoqërisë ;
- = Për realizimin e administrimit korekt dhe ligjor të shoqërisë ;
- = Për realizimin dhe krijimin në vijimsi të pasurive e vlerave materiale, në emër e për llogari të shoqërisë ;

Administrator i shoqërisë "R&A" Shpk Peqin, caktohet Ortaku i vetëm,

Zoti Hysen MALKJA, i biri i Ismail-it dhe i Shpresa-s, lindur më 16 Gusht të vitit 1963 në Peqin, me Kombësi e Shtetësi Shqiptare, banues në adresën Lagja "XHAMI" Peqin, me dokument identifikimi :

Pasaporta Nr. Z 0122106.

NENI 11 *Të drejtat e detyrat e administratorit*

Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyra :

= Drejton, administron dhe përgjigjet, brënda objektit të shoqërisë, të gjithë veprimtarinë administrative, teknike e financiare të shoqërisë dhe kundrejt të tretëve. Ai përgjigjet ndaj shoqërisë dhe personave të tretë për shkelje prej tij me faj, të aktit të themelimit, të Statutit dhe të dispozitave ligjore.

= Përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me persona fizik e juridik, pranë Organeve të Pushtetit Qëndror e Vëndor, pranë organeve gjyqësore, si dhe në të gjitha rastet kur kërkohet përfaqësimi i shoqërisë me të tretë,

gjithmonë në përmbushje të detyrimeve të shoqërisë dhe në përputhje me objektin dhe veprimtarinë e shoqërisë dhe në interesin e saj ;

= Mënyrë kontratat e çdo lloj me të tretë, persona fizik e juridik, vëndas brënda Shqipërisë, si dhe të huaj, në bazë të autorizimit të ortakut të vetëm.

= Harton dhe zbaton kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe harton kontratat e punës për punonjësit e shoqërisë, të nevojshëm për realizimin e detyrave të saj ;

= Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së shoqërisë, administratori në mbyllje të vitit financiar harton raportin vjetor për administrimin, ku paraqitet gjëndja e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, si dhe kryen inventarët dhe bën llogaritë vjetore të shoqërisë.

= Mbikqyr garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura si dhe atë të punimeve të kryera ;

K R E U I V

D I S P O Z I T A E K O N O M I K E

N E N I 1 2 *Veprimtaria ekonomike.*

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë, zhvillohet bazuar në aktet nominale të organit vendimtarës dhe administratimit prej Administratorit të shoqërisë, veprimtari që konsiston në realizimin e :

Shoqëria është përdoruese e disponuese e pasurisë së saj.

Ajo në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së vet mund të shesë pasurinë, të blejë pasuri dhe, t'a shfrytëzoj atë.

Pasuria e shoqërisë vlerësohet nëpërmjet bilanceve ekonomiko-financiare të saj.

Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar i vitit pararendës, konform dispozitave ligjore në fuqi, brënda 6 mujorit të vitit pasardhës.

Për detyrimet e veta në qarkullimin tregëtar ndaj personave të tretë, juridikisht shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj.


Nga të ardhurat e shoqërisë, mbasi zbriten shpenzimet e njohura ligjërisht, pra fitimi i saj, i takon ortakut të vetëm.


Viti ekonomik i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti, duke qënë i njëjlojtë me vitin kalendarik.

N E N I 1 3 *Llogaria e shoqërisë.*

Shoqëria ka llogarin e saj bankare. Ajo mund të çeli llogari të tjera në bankë, brënda ose jashtë Shqipërisë me vendim të ortakut të vetëm dhe në përputhje me legjislacionin bankar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

N E N I 1 4 *Miratimi llogarive.*



Raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga administratori, i nënshtrohen miratimit të ortakut të vetëm brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar prej datës së mbylljes së vitit financiar, sipas procedurës së përcatuar në nenin 56 të ligjit "Për shoqëritë tregëtare"

Për nxitjen e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, nga fitimi rezervuar gjatë vitit financiar krijohen fondet e shoqërisë.

Fondi i rezervës së domosdoshme krijohet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 213 të ligjit "Për shoqëritë tregëtare".

Ortaku i vetëm gëzon të drejtën që të marrë në çdo kohë njoftime dhe të njihet me dokumentacionin e shoqërisë me qëllim që të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë e shoqërisë.

NENI 15 *Kontrulli Kontabël*

Shoqëria mban libra për të regjistruar të gjitha veprimtaritë e saj në bazë të rregullave të kontabilitetit që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Për realizimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë, mbahen librat kontabël, të cilët kontrollohen çdo vit prej Ekspertit Kontabël të Autorizuar, i cili emërohet prej ortakut të vetëm. Kompetencat, funksionet, detyrat, përgjegjësitë, zvendësimi, shkarkimi dhe shpërblimi i tij, bazohen në VKM Nr. 150 dt. 31.03.2000 "Rregullore EKA"

NENI 16 *Udarja e fitimit.*

Fitimet e realizuara nga shoqëria i takojnë ortakut të vetëm, të cilat, Ai mund t'i transferojë lirisht jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.


NENI 17 *Prishja e shoqërisë*

Shpërndarja e shpk bëhet :

- =Me realizimin e objektit të përcaktuar ;
- =Në rastet e pamundësisë të realizimit të objektit ;
- =Pushimi i veprimtarisë vendoset kur ka arsye objektive ;
- =Kur deklarohet i pa aftë ortaku i vetëm ;
- =Me vendim gjyqësor ;
- =Në raste të tjera të parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 18 *Procedura e likuidimit*

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes. Pas prishjes shoqëria likuidohet. Për këtë qëllim ortaku i vetëm cakton likuiduesin ose komisionin e likuidimit. Shoqëria i jep fund veprimtarisë



së saj në çastin e miratimit të bilancit të likuidimit prej ortakut të vetëm Bilanc financiar përfundimtar, që i paraqitet atij prej likuiduesit apo komisionit të likuidimit.

NENI 19 *Dispozita të fundit*

Të gjitha dokumentat e shoqërisë do të plotësohen sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
Për çështje të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë, që nuk parashikohen apo që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi. *

NENI 20 *Hyrja në fuqi*


Ky statut i hartuar për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "RE & AL" SHPK PEQIN, në 3 (tre) ekzemplarë të njëllëjta, hyn në fuqi me nënshkrimin e tij prej ortakut të vetëm, në Peqin, sot më datë 25 Janar 2004.

*

- A. Ligji Nr. **7632** Datë 04.11.1992
"Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar."
- B. Ligji Nr. **7638** Datë 19.11.1992
"Për Shoqëritë Tregëtare" (me ndryshimet e pësuara)
- C. Ligji Nr. **7667** Datë 28.01.1993
"Për Regjistrin Tregëtar dhe formalitete që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare."
- D. Ligji Nr. **7850** Datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të R.Sh."
